

VENDIM
Nr.61, datë 21.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË VENDIMIN NR.558, DATË 16.8.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM, NË MINISTRINË E BRENDSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.558, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Për pagat e punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe të Inspektimit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Brendshme”.
 - b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe të Inspektimit të Përgjithshëm, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“3. Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi (kolonat 4 e 5 të lidhjes nr.1) jepet sipas funksioneve, të përcaktuara në këtë lidhje.”.
 - ç) Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. “Specialistët, përgjegjësit e sektorit apo drejtorët e shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe të Inspektimit të Përgjithshëm, të cilët punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së këtyre drejtorive dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore, të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.
 - d) Pikat 5 e 6 numërtohen, përkatësisht, 7 e 8.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2009 do të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Brendshme, në buxhetin e vitit 2009.
 3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij zbatimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesat për natyrë të veçantë pune e shërbimi	
			Në funksion të shërbimeve mbështetëse të SHKB	Në funksione të drejtorisë së SHKB
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	33 000	2000	6500
	Agjent i I-rë	34 500	2000	6500
	Asistent	36 500	2000	6500
	Asistent i I-rë	37 500	2000	6500
	Kryeasistent	39 000	2000	6500
I mesëm	Nëninspektor	46 500	2000	6500
	Inspektor	48 500	2000	6500
	Kryeinspektor	55 500	2000	6500
I lartë	Nënkomisar	68 000	2000	7500
	Komisar	82 000	2000	7500
	Kryekomisar	94 000		20 000